



Pranuar / Dorezuar Pritiljeno/Prodato Received/Delivery	19.05	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Hr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKUMSHCK	2939/2022		113	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.326/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtar, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, ka shqyrtuar ankesën A.nr.326/2022 të datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rruga kundër heshtje së organit të punësimit Ministria e Shëndetësisë, në çështjen juridike “kërkesë nga marrëdhënia e punës/kthim në vendin e punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 19.05.2022 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedura administrative e filluar sipas ankesës me numër A.nr. 326/2022 të datës 04.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi përmes përfaqësuesit të tij me autorizim më datë 04.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 1838/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos trajtimit të kërkesës për shfuqizim të vendimit për pezullim nga detyra dhe kthimin në vendin e punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 07.05.2022 ka proceduar kërkesën e ankuesit për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Shëndetësisë. Ndërsa Këshilli, më datë 14.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.



Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.326/2018 të datës 04.04.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin për përfaqësim të datës 01.04.2022; Aktgjykimin PKR.nr.22/2021 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda; Aktgjykimin APS.nr.1/2022 i Gjykatës së Apelit të Kosovës -Departamenti Special; Kërkesën për shfuqizimin e vendimit për pezullim nga detyra dhe kërkesë për kthimin në vendin e punës me numër protokolli 05-790 e datës 18.02.2022 nga ankuesi për Ministrinë e Ministrisë së Shëndetësisë; Autorizimin e datës 04.04.2022; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 07.04.2022; Përgjigjen në ankesë e datës 14.04.2022; Përgjigje në kërkesë e datës 04.04.2022 nga Ministri i Shëndetësisë për përfaqësuesin e ankuesit; Opinionin e Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë; Vendimin me Nr. 07/125 i datës 09.08.2007 i Kryesuesit të Komisionit për Emërim të Larta Publike; Kontrata e Marrëdhënies së punës me Nr. Prot:07/130 e datës 09.08.2007 e lidhur me ankuesit dhe Komisionit për Emërim të Larta Publike; Shkresë me titull zbatimi i vendimit të KELP-it me Nr. 133 e datës 14.08.2007; Vendimin me Nr. 79/2012 i datës 12.01.2012 i Ministrisë së Shëndetësisë për pezullimin nga pozita të ankuesit; Kartelë e nëpunësit (ankuesit) e vitit 2012, 2013, 2014, 2015, 2016, dhe 2017; Aktgjykimin A.nr.791/2008 të Gjykatës Supreme të Kosovës; Vendimin me numër protokolli 05-4428 i datës 28.09.2010 i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin me Nr. 192 i datës 09.05.2008 i Kryesuesit të Komisionit për Emërim të Larta Publike; Vendimin me numër protokolli 05-957 i datës 01.03.2008 i Ministrisë së Shëndetësisë; Vendimin A.nr.290/2018 i datës 15.08.2018 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin Nr. 250/2017 i datës 07.12.2017 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Raportin e Mbikëqyrjes së Zbatimit të Rregullave dhe Parimeve të Legjislacionit për Shërbimin Civil në Ministrinë e Shëndetësisë i datës 07.12.2017, kërkesën e datës 18.05.2022 për tërheqje të ankesës me nume protokolli 2912/2022 të datës 19.05.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, ka konstatuar së janë përmbushur kushtet ligjore që të përfundoj procedimi administrativ i filluar me ankesën A.nr.326/2022 të datës 04.04.2022, SEPSE:

Bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi përmes përfaqësuesit me autorizim më datë 04.04.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër mos trajtimit të kërkesës për shfuqizim të vendimit për pezullim nga detyra dhe kthimin në vendin e punës, me pretendime që pas lirimit nga aktakuza respektivisht përfundimit të procedurës penale, janë krijuar kushtet ligjore që të kthehet në vendin e punës respektivisht në pozitën e mëparshme duke u bazuar në nenin 69 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe nenin 58 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Ndërsa me datë 18.05.2022 ankuesi ka parashtruar kërkesë për tërheqjen e ankesës të datës 04.04.2022, andaj, bazuar në këtë veprim të ankuesit, e në kuptim të dispozitave të nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *"Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë"*, Kolegji konstaton së janë plotësuar kërkesat ligjore për përfundim të procedurës administrative të filluar me ankesën A.nr.326/2022 të datës 04.04.2022.



Nisur nga konstatimi si me sipër, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave mbështetur në nenin 103 paragrafit 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe nenin 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.326/2022

Avdyj BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit Avokat
- Ministrit të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Shëndetësisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

